NDREQJE GABIMI

Në Fletoren Zyrtare nr.194, dhjetor 2009 në ligjin nr.10 209, datë 23.12.2009 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, në nenin 11 pika 2, bëhet ndreqja e gabimit si më poshtë:

Ishte:

2. Pas pikës 1 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“2. Subjektet tatimpaguese, të cilat tregtojnë apo mirëmbajnë pajisje fiskale te subjektet e tjera tatimpaguese, pa qenë të licencuara nga Ministri i Financave, dënohen me gjobë në masën 1 000 000 (një milion) lekë, ndërsa shoqëritë që blejnë dhe përdorin pajisje të tilla fiskale dënohen me gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë dhe sekuestrim të pajisjes fiskale.”.

Bëhet:

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Subjektet tatimpaguese, të cilat tregtojnë apo mirëmbajnë pajisje fiskale te subjektet e tjera tatimpaguese, pa qenë të licencuara nga Ministri i Financave, dënohen me gjobë në masën 1 000 000 (një milionë) lekë, ndërsa shoqëritë që blejnë dhe përdorin pajisje të tilla fiskale dënohen me gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë dhe sekuestrim të pajisjes fiskale.”.